



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODER

DREJTORIA E PERGJITHSHME E MIREMBAJTJES SE OBJEKTEVE PUBLIKE

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore-Bojatisja**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45442110-1 - Lyerje ndërtesash, 98316000-1 - Shërbime lyerjeje

VLERA E FONDIT LIMIT: **10 949 090** (dhjetë milionë e nëntëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëdhjetë) **leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Pergjithme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76 ”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike*

*ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*,

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres se fondit limit e konkretisht **4 379 636** (Katër milion e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *”Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”*.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2023-2024-2025 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar nëse është e mundur, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat

financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2026) (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2026.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet e kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe konkretisht **2 189 818** (Dy milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4. "ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". *Per kontrata e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jete ne një vlere jo me te madhe se 20 % te vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates*".

**Argumentimi** Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jete afer limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me liçense profesionale lëshuar nga organet perkatese, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

**-Kategoria NS-4, Niveli A - "Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese."**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente duke u bazuar ne kerkesat specifike te percaktuara ne termat e references.

Bazuar në objektivat e projektit dhe komponentët kryesorë të tij janë përcaktuar kategoritë e mësipërme të licensës së projektimit të Operatorit Ekonomik të cilat janë të domosdoshme për hartimin e projektit dhe përputhen me natyrën e shërbimit dhe sipas deryres se projektimit.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në pdrputhje me standartet kombëtare ose europiane." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve te ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

#### **Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:**

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NS - 4</u>	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me	Zeri ne preventive Kap A,B,C	Niveli A	<b>10 949 090</b>

	materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese			
--	---	--	--	--

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 17 (shtatëmbëdhjetë ) persona** për muajin e fundit. Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DST. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet në rastin kur operatori shpallet fitues ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 4, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Prandaj ne lidhje me përcaktimin e numrit te punonjesve eshte perdorur edhe eksperiencia e meparshme nder vite duke qene se edhe nga eksperiencia e te gjitha ketyre viteve ka rezultuar e sukseshme dhe i mjaftueshem nje numer i tille punetoresh per te realizuar sherbimin e mirembajtjes  
Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

Afati 3(tre) muaj

Ore totale pune	378	2363	5810
Ore ne nje dite pune	8	8	8
Dite pune ne nje muaj	22	22	22
Muaj pune sipas grafikut	3	3	3
Nr I puntoreve	0.715151515	4.475378788	11.00369318
Lloji I puntorit	<b>Puntor pa kualifikuar</b>	<b>Murator</b>	<b>Bojaxhi</b>

Ateher vendosim

1 Puntor te pakualifikuar

5 Murator  
11 Bojaxhi

## **Totali 17 punonjes**

**Argumentimi:** Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese eshte e mbështetur në Nenin 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

### **2.3.4 Operatori ekonomik për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor:** 1 (nje) inxhinier ndërtimi.**

Inxhinieri duhet te jete i siguruar dhe te figuroje ne listepagesat perkatese E-Sig për të paktën muajin e fundit.Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: a) Kontratën individuale të punës, dhe b) Diplomën e inxhinierit të mësipërm

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DST. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet në rastin kur oper shpallet fitues ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e ketij kriteri per stafin eshte bere ne perputhje me kerkesat e shprehura ne termat e references Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

Eshtë kërkuar inxhinier ndertimi për zbatimin e punimeve ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit ,projektit, specifikimeve teknike qe do te zbatohen dhe si dhe kategorive perkatese ne licencen perkatese te zbatimit,Inxhinieri ndertimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve.Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve qe vendosen ne objekt .

### **2.3.5 Vetdeklarimin nga inxhinieri i ndertimit se ai eshte i disponueshem për realizimin e kësaj kontrate.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar ne [Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020”Mbi Problematikat e konstatuara gjate monitorimit](#) nga APP”

**2.3.6 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtnuesin Teknik të punimeve në objekt,** i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, te figuroje i punesuar me kohe te plote ne listepagesa.**

Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) CV, b) Kontratën e punës dhe c) Diplomën.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DST. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet në rastin kur oper shpallet fitues ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshte vendosur ky kriter duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar,pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendim Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier"

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- **1 (një)** punonjës të disponojë certifikatë si "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune”, e dhene nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*

**Argumentimi 2.3.7:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 .... Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurise e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institucion ...., dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier ". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te reazlizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

Bazuar dhe ne V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për

vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, ku nga këta të jenë të paktën:

1 ( nje ) Puntor te pakualifikuar

5 (pese) Murator

11 (Njembedhjete) Bojaxhi

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, deshmime e kualifikimit nga organe/institute te akredituar per punonjesit si dhe listëpagesen për të paktën muajin e fundit.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Ore totale pune	378	2363	5810
Ore ne nje dite pune	8	8	8
Dite pune ne nje muaj	22	22	22
Muaj pune sipas grafikut	3	3	3
Nr I puntoreve	0.715151515	4.475378788	11.00369318
Lloji I puntorit	<b>Puntor pa kualifikuar</b>	<b>Murator</b>	<b>Bojaxhi</b>

Vendosja e ketyre kriterëve per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur si dhe mjeteve te kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

Kerkesa qe punonjesit te jene me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë eshte bere bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet te paraqesin deshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme sipas dispozitave te ligjit nr.8734, datë 1.2.2001 për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se disponon minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

Nr.	Mjetet	në pronësi ose me qira	Sasia
1	Mjet transporti vetshkarkues deri 3 ton	në pronësi ose me qira	1 copë
2	Skeleri	në pronësi ose me qira	150 m <sup>2</sup>
3	Betoniere	në pronësi ose me qira	1 cope
4	Autovinc me kosh MT	në pronësi ose me qira	1 cope
5	Matrapik	në pronësi ose me qira	1 cope
6	Kokore	në pronësi ose me qira	1 cope
7	Jeleke	në pronësi ose me qira	1 cope
8	Kuti e ndihmes shpejte	në pronësi ose me qira	

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Si dëshmi për ploteësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- v. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- vi. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit *Publik*”.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Mjet transporti vetshkarkues deri ne 3ton(ngarkesa)**

Transport material (boje)  $m^2$  16000 \*0.2=3200 liter

$$3200 * 1.3 = 4160$$

Transport vinovil  $m^2$  16000\*0.2=3200 liter

$$3200 \text{ liter} * 1.3 = 4160$$

Atehere 8468:44 dite=131 kg ne ditë mesatarisht 1(nje) rruge ne dite

Transport boje vaji  $m^2$  140\*0.2=28 kg

Totali 5772.92 kg

2000  $m^2$  suva \* 6.6 kg cemento = 13200

500  $m^2$  suva \*5.5 kg cemento = 1925

Atehere 13200:22 dite=600 kg ne ditë mesatarisht 1(nje) rruge ne dite

Autovinc me kosh MT – nevojitet per punime suva solete sipas zerave te preventivit ose lyerje fasade

Matrapik - per thyerje te shtresave te soletes

Kokore,Jelege Kutu i ndihmes se shpejt – pajisje te nevojshme per mbrojen dhe sigurine ne pune.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes.

**2.3.10** Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara te bojes per lyerje, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte modeli i bojes per lyerje qe do te ofrohet. Pjeset e katalogut te prodhuesit ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve duhet te jene te perkthyer ne shqip.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofetuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor për pajisjet që propozon/oferton.*

**2.3.11** Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim te prodhuesit/Distributorit te autorizuar per mallrat e kerkuara. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast se do te paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vertetoj kete duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi për pajisjet/artikujt e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e artikujve dhe nevojës për garanci mbi efencën dhe kapacitetet teknike të pajisjeve/ artikujve.

**2.3.12** Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës dhe në rastin kur ai nuk është prodhues të paraqesë certifikatën përkatëse të prodhuesit/distributorit të autorizuar të mallrave objekt prokurimi. Konkretisht:

1. ISO 9001-2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

2. ISO 14001-2015 “Standart për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”),/ekuivalente dhe e vlefshme.
3. ISO 45001:2018 “Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit nëpunë”/ekuivalente dhe e vlefshme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim:* Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

*Kujdes:* Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e

*kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to.